

## TË DHËNA TË HERSHME PËR EKZISTENCËN E GJUHËS SHQIPE

Robert Elsie

Megjithë kërkimin intensiv dhe interesin pasionant të treguar nga studiuesit shqiptarë, origjina e shqiptarëve si popull mbetet e veshur me mister. Gjysma e dytë e mijëvjeçarit të parë që është vendimtare në këtë aspekt (500-1000 pas Krishtit), e cila mund të siguronte vijën e humbur deri tek banorët ilirë të rajonit në antikitet, në të vërtetë nuk përcjell asnjë informacion dhe regjistrim gjuhësor të stadeve të hershme të shqipes, ç'ka do të shërbenin si udhëzues të besueshëm. Në të vërtetë nuk ka asnjë gjurmë thelbësore të gjuhës shqipe që të datojë para shekullit të 15-të, kur u shfaqën tekstet e para: teksti disi misterioz Belifortis i vitit 1405, Formula e famshme e Pagëzimit e Pal Engjëllit e vitit 1462, një mallkim nga viti 1483, i ashtuquajtur i Ungjill i Pashkës ose Perikope që përgjithësisht mendohet të datojë nga fundi i shekullit të 15-të dhe fjalori i shkurtër i Arnold von Harff-it, një pelegrin gjerman, i cili gjatë rrugës së tij për në Tokën e Shenjtë, gjatë një ndalese që bëri në Durrës në pranverën e vitit 1497, regjistroj 26 fjalë, 8 fraza dhe 12 numra të shqipes.

Ndërsa kryqëzatat dhe pushtimi Anzhuin i Shqipërisë, më 1269 i siguruan botës perëndimore disa informacione rreth Shqipërisë si një rajon gjeopolitik, çuditërisht në veprat historike dhe udhëtimet përshkruese jepen pak të dhëna për vetë shqiptarët. Ajo çfarë njihet nga kjo periudhë është përpiluar dhe grumbulluar nga Alen Duselier në një seri artikujsh dhe në monografinë e tij madhore 701-faqëshe për vijën bregdetare shqiptare nga shekulli XI-XV.

Ndonëse historianët bizantinë, mbi të cilët duhet të mbështetemi për shumë nga njohuritë tona për Ballkanin Jugperëndimor në shekujt që paraprijnë tekstet e sipërpërmendura, kanë lënë detaje luftrash, revoltash dhe ndryshimesh politike në këtë rajon, shpesh ata tregohen çuditërisht të heshtur, kur bie fjala për gjuhën dhe zakonet e popullsisë jogleke të territoreve të tyre periferike, një indiferencë ndaj 'barbarëve,' të cilën mund ta kenë trashëguar nga grekët e lashtë.

Në përgjithësi është pranuar se fiset e hershme shqiptare, të favorizuara nga kolapsi i madh që kishte mbërthyer perandorinë bullgare në fund të shekullit X, filluan të zbrisin nga vendbanimet e tyre malore në shekujt XI-XII, ku ata jetonin si barinj nomadë, fillimisht duke marrë zotërim të plotë të brigjeve veriore dhe qëndrore shqiptare dhe nga shek XIII duke u përhapur në jug, drejt asaj çfarë është tani Shqipëria e jugut dhe në Maqedoninë perëndimore. Fillimisht ata hynë në analet e historisë post-klasike të shkruar në gjysmën e dytë të shek. XI dhe vetëm në këtë kohë mund të flitet me një shkallë sigurie për një popull shqiptar, ashtu siç i njohim ata sot, megjithëse paraardhësit e tyre, padyshim me një element të theksuar ilirik, duket se kanë banuar në të njëjtat male të Shqipërisë veriore qysh prej kohëve antike. Në veprën e tij 'Historia,' të shkruar në vitet 1079-1080, historiani bizantin Mikel Ataliati, ishte i pari që u referohej me termin *Albanoi* atyre që ishin marrë pjesë në një revoltë kundër Konstandinopojës më 1043, dhe me *Arbanitai* atyre që ishin subjekte të dukës së Dyrrahut.

Prandaj, perioda e kristalizimit, - për ta shmangur termin shumë të ndërlikuar etnogjenezë e popullit shqiptar, - mund të vendoset në shekujt XI dhe XII dhe çdo e dhënë apo informacion rreth shqiptarëve, sidomos për gjuhën e tyre në këtë periudhë, duhet vënë nën fokusin e një vëmendjeje të veçantë.

Të dhënat më të hershme për ekzistencën e gjuhës shqipe në vetvete u shfaqën rreth fillimit të shek. XIV. Në fakt, në kemi katër të dhëna të qarta e të pakontestueshme midis 1285 dhe 1332.

E para nga këto të dhëna historike, ajo e vitit 1285, nuk shfaqet në Shqipëri, por në Dubrovnik (Ragusa), ku një komunitet i konsiderueshëm shqiptarësh ekzistonte atje prej disa kohësh. Gjatë hetimit të një grabitjeje që kishte ndodhur në shtëpinë e Petro Del Volkios të Belenës (sot Prati), një farë Mateu, bir i Markut të Mançes, i cili mesa duket ka qenë

dëshmitar në krim, pohon:

“*Audivi unam vocem clamantem in monte in lingua albanesca*” (Dëgjova një zë duke thirrur në male në gjuhën shqipe).

Njëzet e tre vjet më vonë, ne hasim një përshkrim të Shqipërisë në të ashtuquajturin *Anonymi Descriptio Europae Orientalis* (Përshkrim anonim i Evropës Lindore), një tekst latin mesjetar i vitit 1308, i cili përmban një pamje të tokave të Evropës Lindore, në veçanti të vendeve ballkanike. Autori i saj anonim mendohet që të ketë qenë një francez, ose një klerik francez i arsimuar, ka shumë mundësi i urdhërit Dominikan, i cili ishte dërguar nga kisha për në Serbi, ku ai mblodhi shumë informacione rreth Ballkanit. Teksti *Anonymi Descriptio Europae Orientalis* gjendet në mjaft kodikë mesjetarë, midis të cilëve Ms. Lat. 5515 dhe Ms. Lat. 14693 në Bibliotekën Kombëtare të Parisit, dhe Ms. Lat. 263 në Bibliotekën Universitare të Leidenit. Dorëshkrimi u botua në Krakov, më 1916 nga Olgierd Górka. Përveç seksioneve që përshkruajnë rajone të ndryshme të Greqisë Bizantine, Rashës, Bullgarisë, Rutenisë, Hungarisë, Polonisë dhe Bohemisë, ai përmban një seksion për Shqipërinë, një nga përshkrimet e rralla të vendit në fillim të shek. XIV. Ky seksion përfundon me të dhënën e mëposhtme për gjuhën shqipe:

“*Habent enim Albani prefati linguam distinctam a Latinis, Grecis et Sclavis ita quod in nullo se intelligunt cum aliis nationibus*” (Shqiptarët e sipërpërmendur kanë një gjuhë e cila është e ndryshme nga ajo e latinëve, grekëve dhe sllavëve, saqë ata në asnjë mënyrë nuk mund të komunikojnë me popuj të tjerë).

E dhëna e tretë për ekzistencën e gjuhës shqipe, vjen nga raportimi që bën një pelegrin gjatë udhëtimit të tij për në Tokën e Shenjtë më 1322. Përshkrimet e peligrinazheve për në Tokën e Shenjtë sigurojnë me të vërtetë një burim parësor informacioni për shumë vende të Mesdheut lindor në gjysmën e parë të mijëvjeçarit të dytë. Megjithatë, ndryshe nga Arnold von Harff-i në 1497, pjesa më e madhe e këtyre pelegrinëve nuk shfaqën veçse interes kalimtar për tokat që ata vizituan gjatë rrugës së tyre. Dy pelegrinë anglo-irlandezë, Simon Semeonis (Simon Fitzsimmons) dhe Hugo Iluminator, qëndruan në Shqipëri më 1322 dhe i pari e përshkroi në mënyrë të gjallë atë që ai pa. Tregimi i tij i na jep një përshkrim të shpejtë dhe të rrallë të bregdetit shqiptar në gjysmën e parë të shek. XIV. Simon Fitzsimmons i urdhërit Franceskan u nis për udhëtim nga Klonmeli i Irlandës në pranverën e vitit 1322 me mikun dhe bashkudhëtarin e tij Hugo Iluminatorin, dhe kaluan nëpër Uellsin verior në Londër, Kanterberi, Dover, Visant, Amiens, Paris, Bon (Beaune), Lion, Avinjon, Nicë, Gjenova, Bobio, Piacenza, Parma, Mantova, Verona dhe Viçenca deri në Venedik. Atje ata hipën një anije tregëtare për në Tokën e Shenjtë, e cila gjatë itinerarit ndaloi në Pula, Zadar, Dubrovnik, Ulqin, Durrës, Korfuz, Qefaloni dhe Kretë, para se të arrinte në Aleksandri. Përshkrimi që Simoni i bën udhëtimit, i njohur si *Itinerarium Symonis Semeonis ab Hybernia ad Terram Sanctam* tani ruhet në një dorëshkrim (nr. 407) në bibliotekën Corpus Christi në Kembrixh. Fillimisht u botua në Kembrixh më 1778, botim ky i rrallë nga Xhejm Nasmith nën titullin *Itinerarium Symonis Semeonis et Hugonis Illuminatoris ad Terram Sanctam* dhe qysh prej kësaj kohe ka qenë botuar nga Mario Esposito dhe Eugjen Hoad (Eugene Hoade). ‘Itinerari’ përmban një informacion të pasur për çështje të tilla si procedurat dhe inspektimet doganore, veshjet tradicionale, monedhat, lëndët e para dhe produktet që prodhoheshin nëpër këto vende tranzite dhe natyrisht për kishat dhe vendet e shenjta që zënë vendin kryesor. Gjatë lundrimit poshtë bregut të Adriatikut, Simoni shkruan:

“*Albanya est provincia inter Sclavoniam et Romanyam, per se linguam habens*” (Shqipëria është një provincë ndërmjet Sllavonisë dhe Romanisë që ka një gjuhë të vetën).

Për qytetin e Durrësit ai vazhdon:

“*Inhabatur enim Latinis, Grecis, Judeis perfidis, et barbaris Albanensibus*” (Ai është i banuar nga latinë, grekë, judenj të pabesë dhe barbarë shqiptarë).

Është mjaft interesante që në lidhje me Dubrovnikun ai i referohet përsëri gjuhës së këtyre ‘barbarëve’:

*“In eadem dominantur Veneti, et ad eam confluunt Sclavi, Barbari, Paterini et alii scismatici negotiatores qui sunt gestu, habitu et lingua Latinis in omnibus diffformes”* (Venecianët dominojnë në të [Dubrovnik] dhe sllavë, barbarë dhe skizmatikë të tjerë e frekuentojnë, të cilët janë plotësisht të ndryshëm nga latinët në tradita, veshje dhe gjuhë).

E dhëna e fundit për gjuhën shqipe dhe ndoshta e para për ekzistencën e saj të shkruar është bërë në 1332 nga një murg dominikan francez Burkard ose Frat Broshar (lat. Brocardus monacus). Në një vepër latine të titulluar *Directorium ad passagium faciendum*, Burkardi shënonte:

*“Licet Albanenses aliam omnino linguam a latina habeant et diversam, tamen litteram latinam habent in uso et in omnibus suis libris”* (Shqiptarët kanë një gjuhë plotësisht të ndryshme nga latinishtja, megjithëse ata përdorin gërma latine në të gjitha librat e tyre).

Megjithëse e dhëna për ekzistencën e gjuhës është e qartë, ajo e shqipes së shkruar është e dyshimtë. Nuk mund të thuhet me siguri, nëse Burkardi donte të thoshte libra në gjuhën shqipe të shkruara me shkrim latin apo thjesht libra të shkruara në latinisht. Mundësia e parë natyrisht që ka zaptuar imagjinatën e studiuesve të brezave pasardhës dhe pjesa e fundit e tekstit shpeshherë citohet në historinë dhe studimin e letërsisë shqiptare.

Cila është rëndësia e këtyre të dhënave? E para dhe kryesorja është se dallohet qartë që në periudhën kohore 1285-1322 gjuha shqipe ishte rrënjësuar mirë në brigjet juglindore të Adriatikut, aq sa të shquhej nga vëzhguesit e huaj që zbarkonin në portet bregdetare të Durrësit dhe Dubrovnikut. Në trajtimin që i bën provincës së Shqipërisë “Përshkrimi Anonim” i referohet popullsisë së saj si “banorë luftëdashës ... të cilët bëjnë harqe dhe heshta të shkëlqyera ... dhe që nuk kanë qytete, kampe, fortifikime dhe ferma, por më tepër jetojnë në tenda dhe janë vazhdimisht në lëvizje nga një vend në tjetrin.” Mirëpo thuhet se porti i Durrësit “i përket latinëve.” Që shqipja duhet të jetë folur gjerësisht në rrafshinat bregdetare dhe rajonet majore në këtë kohë, kjo mund të dëshmohet veçanërisht nga vëzhgimi paraprak i Simon Fitzsimonit, që provinca kishte një gjuhë të vetën, domethënë shqipen. Megjithëse në të dhënë që ai jep për qytetin e Durrësit ‘barbarët shqiptarë’ përmenden të katërtit mbas qytetarëve latinëve, grekëve dhe judenjve, tregues ky që përputhet më ‘Përshkrimin Anonim’ se në atë kohë ata nuk formonin akoma grupin mazhoritar të qytetit.

Datimi i këtyre të dhënave, të gjitha brenda një periudhe më pak se 50-vjeçare, sidoqoftë nuk duhet marrë si tregues që shqipja apo format e hershme të saj nuk fliteshin në shekujt paraardhës. Në qoftë se shqiptarët, ashtu siç na tregon dhe ‘Përshkrimi Anonim,’ ishin nomade të zonave fshatare dhe nëse ngulimet e tyre ishin më të përqëndruara në malësi sesa në zona bregdetare, ka shumë të ngjarë që ata thjesht liheshin jashtë vëmendjes, edhe sikur të kishin krijuar një grup etnik të vërtetë.

Edhe sot ka analogë të ngjashëm, të cilët demonstrojnë, sesi mund të mos vihet re një grup etnik apo minoritet linguistik. Pothuajse të gjitha të dhënat mbi përbërjen etnike të Shqipërisë sot do të përmendnin minoritetin grek në rajonet Gjirokastrë dhe Sarandë, një minoritet të vogël maqedonfolës në disa fshatra të Liqenit të Prespës dhe ndoshta një minoritet serbfolës në bregun lindor të Liqenit të Shkodrës. Fjalori Enciklopedik Shqiptar na jep informacionin e mëposhtëm:

“Sipas regjistrimit të vitit 1979, dolën 54.687 njerëz me kombësi joshqiptare (2,1% e popullsisë së përgjithshme). Nga këta 49.307 janë grekë që jetojnë kryesisht në rajonet kufitare jugore të rrethit të Gjirokastrës dhe Sarandës; 4.163 janë sllavë, shumica e të cilëve maqedonas që jetojnë në fshatrat e Prespës.”

Të gjitha këto lloje të dhënash injorojnë apo nuk marrin në konsideratë dy grupe të tjera etnike apo minoritete linguistike në Shqipëri, të cilat, megjithatë janë shumë më të mëdha se minoriteti sllav apo ndoshta edhe ai grek. Këta janë si arumunët (vllahët), komunitet nomad barinjsh të Shqipërisë juglindore, të cilët flasin një gjuhë të afërt me rumanishten dhe shumë romë të cilët flasin gjuhën e tyre rome. Romët mund të gjenden pothuajse në të gjithë territorin e Shqipërisë. Disa bëjnë jetë nomade, kurse të tjerët në një

farë mënyre janë të ngulitur. Mund të shihen dhe dëgjoen nëpër tregjet e mallrave apo lagjeve periferike të qyteteve. Ata nuk janë injoruar në të dhënat mbi përbërjen etnike të Shqipërisë për arsye politike, por thjesht për shkak të statusit të ulët social të tyre dhe të mënyrës endacake të jetesës që bëjnë. Ata janë të pranishëm në vend, por nuk numrohen. Të dhënat për shqiptarët dhe gjuhën e tyre në Mesjetën e vonë janë të rralla, jo sepse ata nuk ishin kristalizuar si një grup vëllimor etnik, por për shkak të statusit të ulët social dhe të jetës së tyre nomade. Vetëm kur numri i tyre u rrit në atë masë, sa që nuk mund të liheshin më jashtë vëmendjes, bëri që gjuha e tyre të futej në dokumentet e shkruara të periudhës ndërmjet viteve 1285-1332.

[botuar në: *Tempulli, Revistë kulturore periodike*, Korçë, 2000, 2, f. 19-24.]